

ROLI I MEDRESESË “ALAUDDIN” NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR
NË KOSOVË MES VITEVE 1951-1999

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA:

DRIN ALIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

KORRIK, 2021

ROLI I MEDRESESË “ALAUDDIN” NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR NË KOSOVË MES VITEVE 1951-1999

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati: Drin Aliu

Ky punim diplome trajton një temë shumë të rëndësishme “Roli i Medresesë “Alauddin” në procesin edukativo-arsimor në Kosovë mes viteve 1951-1999”. Është bërë përpjekje maksimale që ky punim shkencor të pasqyrohet drejtë, me objektivitet, pa ndikime dhe duke implementuar metodat adekuate shkencore si: Analizën, Sintezën, Përshkrimin dhe Krahasimin. Punimi përmbanë informacione të ndryshme, duke filluar nga burimet arkivore që gjenden në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (Fondi: “Bashkësia e Fesë Islame- Zyra e Vakëfit”), Arkivin e Medresesë “Alauddin”, literaturën e botuar, shtypin, revistat dhe intervistat.

Qëllimi i punimit është që të pasqyrojmë në mënyrë më të detajuar rolin dhe kontributin e Medresesë “Alauddin” në procesin edukativo-arsimor në Kosovës mes viteve 1951-1999. Medreseja “Alauddin” u hap në një kohë shumë të vështirë për popullin dhe vendin, në kohën kur regjimi serbo-jugosllav bënte trysni të madhe mbi popullin shqiptar. Kjo shkollë që nga themelimi i saj, fillimishtë si Medrese e Ulët dhe pastaj si Medrese e Mesme ka dhënë një kontribut shumëdimensional si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar, me theksë të veçantë në zhvillimin dhe avancimin e procesit edukativo-arsimor.

Ky punim përmbëhet nga : pesë kapituj, njëzetë nënkapituj, konkluzionet, dokumente-fotografi dhe në fund paraqiten burimet dhe literatura. Kapitulli i Parë i punimit trajton: Historikun e mejtepeve dhe medreseve në trojet shqiptare dhe rolin e tyre në procesin edukativo-arsimor. Kapitulli i Dytë trajton: Riorganizimin e jetës fetare islame në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, hapjen e Medresesë së Ulët, funksionimin dhe rolin e saj. Kapitulli i Tretë trajton: Shndërrimin e Medresesë së Ulët në Medrese të Mesme, veprimtarinë dhe rolin e saj në procesin edukativo-arsimor. Kapitulli i Katërt trajton: Rolin e mësimdhënësve të Medresesë “Alauddin” në procesin edukativo-arsimor dhe Kapitulli i Pestë trajton: Kontributin e Medresesë “Alauddin” në çështjen kombëtare. Punimi përmbyllet me një përfundim konstruktiv përmes së cilit pasqyrohen rezultatet e arritura gjatë studimit. Pas përfundimit punimi përmbanë një shtojcë të pasur me dokumente dhe fotografi e cila e rritë edhe më shumë vlerën shkecore të punimit. Në fund paraqiten burimet arkivore, literatura, shtypi, revistat dhe intervistat që janë përdorur për realizimin e punimit.

